



# THIRRJE PËR PROJEKT - PROPOZIME

**MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN E  
BIZNESIT ME FONDE PËR VITIN 2026**



**Afati  
30 ditë**

Thirrja qëndron e hapur 30  
(tridhjetë) ditë kalendarike  
nga data e publikimit.

Për më shumë vizitoni faqen e AIDA-s  
[www.aida.gov.al](http://www.aida.gov.al)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve hap thirrjen për mbështetjen dhe zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) për vitin 2026, nëpërmjet fondit “Për zhvillimin e ndërmarrjeve”, sipas përcaktimeve të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022 “Për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”, i cili financohet nga buxheti i shtetit.

Projekt - propozimet e paraqitura nga NMVM-të duhet t'i përmbahen kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për NMVM-të për vitin 2026 për Skemën e Mbështetjes Financiare për Shpenzimet Korrente të Programit Ekonomik.

## Qëllimi i Skemës

Skema synon të mbështesë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në:

- Rritjen e konkurrueshmërisë në tregun vendas dhe ndërkombëtar;
- Përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve;
- Rritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknologjike;
- Nxitjen e inovacionit dhe transformimit digjital;
- Përmirësimin e aksesit në tregje dhe orientimin drejt eksportit;
- Krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të biznesit;

Mbështetja financiare për çdo ndërmarrje:

Mbulon deri në  
**100% të**  
kostove të  
miratuara

Jo më shumë  
se **2,500,000**  
lekë për  
projekt

# Aktivitetet që Mbështeten

**Skema mbështet kostot për shpenzimet korrente që lidhen me zhvillimin e biznesit, si më poshtë:**

**i)** Certifikim i standardeve të prodhimit/ shërbimit (përfshirë konsulencën përkatëse në fazën përgatitore);

**ii)** Përmirësim i produktit përmes ambalazhimit, etiketimit;

**iii)** Trajnime të stafit të ndërmarrjes për rritje kapacitetesh në fusha të tilla si: menaxhimi i teknologjive digjitale/inovatore, rrjetet e prokurimit, shërbime marketingu, zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës së biznesit, sisteme të reja logjistike software apo pajisje të reja, etj, dhe pajisje me çertifikatat përkatëse nga subjekte të licencuara për trajnime;

**iv)** Krijimi i aplikacioneve apo platformave në funksion të zhvillimit të proceseve lidhur me tregtinë elektronike/e-commerce, produkteve të reja dhe/ose shërbimeve, për të përmbushur kërkesat e industrisë së tregut në vend dhe rajon për të përmirësuar biznesin, sistemet logjistike etj;

## Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të shoqërojë kërkesën për aplikim, është si më poshtë:

- a)** Formulari i kërkesës i plotësuar;
- b)** Formulari i buxhetit;
- c)** Certifikatë e regjistrimit në regjistrin tregtar;
- d)** Ekstrakti Historik i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me status aktiv;
- e)** Deklaratën për kategorinë e NMVM-ve, në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 5 të ligjit nr. 43/2022;
- f)** Vërtetim që subjekti ka paguar të gjitha detyrimet tatimore, në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi, të shkarkuar nga E-Albania;
- g)** Vërtetim që subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore, në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi, të shkarkuar nga E-Albania;
- h)** Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që ka paguar detyrimet doganore në, në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi, të shkarkuar nga E-Albania;
- i)** Pasqyrat financiare të vitit të fundit të ushtrimit të aktivitetit të certifikuara nga organet tatimore dhe/ose Formulari i deklarimit të të ardhurave, i shkarkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- j)** Dëshmi Penaliteti të administratorit të ndërmarrjes;
- k)** Kopje të ID-së të administratorit të NMVM-së ose prokurë përfaqësimi dhe ID e përfaqësuesit në rast se aplikuesi nuk është administratori i NMVM-së;
- l)** Çdo dokument tjetër shoqëruar që në vlerësimin e aplikuesit mbështet aplikimin e tij/saj.

# Kush Mund të Aplikojë

Mund të aplikojnë:

**Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM)** që operojnë në Republikën e Shqipërisë dhe plotësojnë kriteret sipas ligjit nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.  
Nuk mund të përfitojnë ndërmarrjet që kanë marrë financim nga donatorë apo institucione të tjera për të njëjtat aktivitete apo shpenzime.

Projektet do të vlerësohen bazuar në:

- Përputhshmërinë e planit të biznesit me objektin dhe qëllimet e dhënies së fondit duke pasur në fokus nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm;
- Qartësinë, saktësinë dhe objektivitetin e planit të biznesit, elemente të cilat identifikohen nëpërmjet rezultateve të matshme nga realizimi i tij;
- Qartësinë e përshkrimit të aktiviteteve që do të realizohen;
- Qartësinë e përshkrimit të impaktit dhe rezultateve të matshme;
- Të dhënat konkrete që aktivitetet e ndërmarrjes rrisin numrin e të punësuarve;
- Të dhënat konkrete dhe të argumentuara për impaktin pozitiv mjedisor.

Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen në rrugë elektronike në adresën [ndermarrje@aida.gov.al](mailto:ndermarrje@aida.gov.al), të skanuara, firmosura dhe vulosura nga aplikuesi, origjinal ose kopje të njehsuar me origjinalin dhe të kenë afat vlefshmërie jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit për fonde.



Shkarko  
Dokumentacionin  
e Aplikimit



Albanian Investment Development Agency  
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve